ANALIZË

Hulumtimi sasior i modelit të diskriminimit ndaj pakicave në Mal të Zi

GRAĐANSKA ALIJANSA
Civic Alliance - Aleanca Qytetare

Titulli i publikimit:
Hulumtimi sasior i modelit të diskriminimit ndaj pakicave në Mal të Zi

Botues:

GRAĐANSKA ALIJANSA
Civic Alliance - Aleanca Qytetare

Për botuesin:
Milan Radoviq

Hulumtimin e realizoi:
Instituti "Damar"

Autorja e publikimit:
Jovana Davidoviq Vuletiq

Redaktore:
Jelena Ristoviq

Përkthyes:
Admir Gjoni

Dizajn dhe përgatitje për shtyp:
Studio Fler

Shtypi:
AP Print, Podgoricë

Tirazhi:
200 kopje

Fond za zaštitu i ostvarivanje manjinskih prava

DAMAR
puls svake teme

Hulumtimi mbi modelet e diskriminimit ndaj pakicave në Mal të Zi është realizuar nga OJQ Aleanca Qytetare në bashkëpunim me Institutin DAMAR, në kuadër të projektit "Festojmë diversitetin. Kultivojmë kulturat", i mbështetur nga Fondi për Mbrojtjen dhe Realizimin e të Drejtave të Pakicave.

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdo qëndrimet e donatorit. Lejohet citimi dhe përdorimi i informacionit nga ky botim, me kusht që të përmendet burimi dhe pronari i të drejtave autoriale. Nuk lejohet përdorimi i materialeve për qëllime të tjera pa miratimin paraprak nga Aleanca Qytetare. Shprehjet që përdoren në këtë botim për personat në gjininë mashkullore përfshijnë edhe format për gjininë femërore. Aleanca Qytetare nuk mban përgjegjësi për pjesët e marra nga burime të jashtme.

Podgoricë, qershor 2024

PËRMBAJTJA

HYRJE.....5

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT.....7

GJETJET KRYESORE TË HULUMTIMIT.....8

I Perceptimet për praninë e diskriminimit.....10

II Perceptimet për mbrojtjen institucionale.....20

III Distanca etnike.....31

PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET.....37

REFERENCAT.....41

HYRJE

Shoqëritë në të cilat ekziston një nivel i dukshëm i diskriminimit, qëndrimi negativ ndaj diversitetit dhe mungesa e përfshirjes, s'mund të jenë demokratike. Diskriminimi, sipas përkufizimit të Kombeve të Bashkuara, është "çdo trajtim i padrejtë ose diferencim arbitrar" (Kombet e Bashkuara 2019) i bazuar në një veçori të caktuar personale. Në thelb të diskriminimit është mohimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrje të plotë në shoqëri, që shpesh ushtrohet mbi individë ose grupe shoqërore. Pavarësisht nga pasojat e mëdha që mund të ketë për individët, diskriminimi mbetet një problem i rëndësishëm shoqëror që pengon ndërtimin e një komuniteti të qëndrueshëm. Diskriminimit shpesh i paraprijnë stereotipet dhe paragjykimet, gjegjësisht gjeneralizimet e pajustifikuara, kognitive dhe afektive, për të tjerët.

Në kontekstin e Malit të Zi, puna për parandalimin e diskriminimit ende s'ka dhënë rezultate të kënaqshme. Për Malin e Zi, procesi i integrimeve evropiane nënkupton jo vetëm harmonizimin formalo-juridik, por edhe pajtimin mbi vlera me Bashkimin Evropian. Në Raportin e Komisionit Evropian të vitit 2023, është theksuar se mungon zbatimi i kuadrit ligjor dhe se janë të nevojshme përmirësime shtesë në fushën e luftës kundër diskriminimit (Raporti i KE 2023, 5). Njëkohësisht, Komisioni Evropian ka theksuar se "grupet më të rrezikuara në shoqëri (përfshirë Romët dhe Egjiptianët, personat me aftësi të kufizuara, personat LGBTIQ) vazhdojnë të jenë të ekspozuara ndaj diskriminimit, gjuhës së urrejtjes dhe krimeve mbi bazën e urrejtjes" (Raporti i KE 2023, 5). Në Raportin mbi mbrojtjen nga diskriminimi të Avokatit të Popullit të Malit të Zi për vitin 2023, janë regjistruar 11 ankesa të qytetarëve për diskriminim mbi bazën e përkatësisë kombëtare (Raporti i Avokatit të Popullit, 2023), ndërsa në analizën e të drejtave të njeriut të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Mal të Zi janë identifikuar fusha të ndryshme të diskriminimit etnik, si mbrojtja sociale, arsimi dhe pjesëmarrja politike (Ambasada e SHBA-së, 2023). Në Raportin Vjetor të Bashkimit Evropian për të drejtat e njeriut dhe demokracinë në botë është konstatuar se Mali i Zi duhet të "përmirësojë kuadrin ligjor dhe institucional për të rritur mbrojtjen nga diskriminimi..." (Raporti i KE-së, 2023).

Duke pasur parasysh se multikulturalizmi, si një nga parimet themelore të shtetit të shpallura në preambulën e Kushtetutës së Malit të Zi, bazohet në mungesën e diskriminimit, është e rëndësishme të vlerësohen perceptimet e qytetarëve për grupet e diskriminuara dhe nivelet e diskriminimit. Objektivi i kësaj analize është të shqyrtojë perceptimet mbi përhapjen e diskriminimit në Malin e Zi, me fokus të veçantë në pozitën e pakicave dhe pjesëmarrjen e tyre në shoqërinë malazeze.

Analiza është ndarë në tri njësi tematike. Në njësinë e parë hulumtojmë qëndrimet e përgjithshme mbi respektimin e të drejtave të njeriut në Malin e Zi, përkatësisht mbi format më të dukshme dhe më të zakonshme të diskriminimit. Kapitulli i dytë shqyrton në çfarë mase qytetarët kanë njohuri mbi mekanizmat institucionalë për mbrojtjen nga diskriminimi dhe veçanërisht mbi mjetet për mbrojtjen e të drejtave të pakicave, kurse në segmentin e tretë analizojmë marrëdhëniet sociale dhe psikologjike ndaj grupeve të ndryshme etnike, përkatësisht distancën etnike. Pjesa e fundit e hulumtimit përmban përfundimet dhe rekomandimet.

Hulumtimi mbi modelet e diskriminimit ndaj pakicave në Malin e Zi është realizuar nga OJQ Aleanca Qytetare në bashkëpunim me Institutin DAMAR, në kuadër të projektit “Festojmë diversitetin. Kultivojmë kulturat”, që u mbështet nga Fondi për Mbrojtjen dhe Realizimin e të Drejtave të Pakicave.

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Të dhënat janë mbledhur nga një kampion prej 1,000 qytetarësh/esh, të anketuar përmes teknikës për grumbullimin e të dhënave CAPI, gjatë periudhës nga 26 prill deri më 5 maj 2024, në 19 komuna të Malit të Zi. Në hulumtim është përdorur një kampion rastësor i stratifikuar me shumë faza, ku njësitë e fazës së parë ishin vendet e votimit, njësitë e fazës së dytë ishin familjet e zgjedhura sipas një hapi të përcaktuar më parë, ndërsa individët në familje u zgjodhën sipas metodës së datëlindjes. Kriteri për përzgjedhjen e mostrës ishte regjistri i popullsisë nga viti 2011, vlerësimet e popullsisë për vitin 2021 dhe regjistri i votuesve për vitin 2021. Ponderimet janë llogaritur në disa hapa të njëpasnjëshme. Fillimisht, janë llogaritur ponderimet e dizajnit. Meqenëse përzgjedhja e zonave të votimit u krye me probabilitete të proporcionalizuara me numrin e personave mbi 18 vjeç, u llogarit probabiliteti i fazës së parë të përzgjedhjes. Në fazën e dytë, u llogarit probabiliteti i përzgjedhjes së familjeve brenda zonave të votimit. Ponderimet përfundimtare për familjet dhe individët u llogaritën duke normalizuar ponderimet, në mënyrë që numri i ponderuar i familjeve/personave të ishte i barabartë me numrin e paponderuar.



GJETJET KRYESORE TË HULUMTIMIT

- Çdo i dyti i anketuar konsideron se diskriminimi është i pranishëm në Mal të Zi;

- Të anketuarit besojnë se diskriminimi në Mal të Zi është më së shumti i pranishëm për shkak të bindjeve politike. Në vendin e dytë është kriteri i orientimit seksual, meqë 68.1% e të anketuarve besojnë se ky faktor më shpesh shkakton diskriminim, ndërsa përkatësia kombëtare është shprehur në masë të madhe si shkak i diskriminimit për 64.3% të të anketuarve;

- Çdo i dhjeti i anketuar është ndjerë ndonjëherë i kërcënuar për shkak të përkatësisë së tij kombëtare. Shumica e të anketuarve me këtë përvojë theksojnë vështirësitë në punësim, veçanërisht në sektorin publik. Disa të anketuar përmendin trajtime mjekësore të vonuara ose trajtim të pabarabartë në shëndetësi bazuar në përkatësinë politike ose identitetin kombëtar. Përgjigjet përfshijnë edhe incidente të ndjenjës së detyrimit për të votuar për parti të caktuara, por edhe ndjenjë të përgjithshme kërcënimi ose diskriminimi në aspekte të ndryshme të jetës, duke përfshirë emërtime fyese, sulme verbale dhe fizike, veçanërisht të lidhura me identitetet kombëtare të të anketuarve;

- 37% e të anketuarve konsiderojnë se pjesëtarët e disa kombësive janë të privilegjuar në krahasim me të tjerët, kurse shumica prej tyre janë të bindur se komuniteti malazez dhe ai serb janë më shpesh në pozicion të favorizuar;

- Mbi 75% e të anketuarve konsiderojnë se Romët dhe Romet janë të diskriminuar në Mal të Zi;

- 69% e të anketuarve besojnë se Romët dhe Romet janë minoriteti më i diskriminuar në fushën e punësimit, kurse 47% e të anketuarve konsiderojnë se ekziston një nivel i lartë diskriminimi edhe në fushën e kujdesit shëndetësor;

- 74% e të anketuarve nuk janë të njohur me veprimet afirmative gjatë punësimit të pjesëtarëve të pakicave kombëtare, ndërsa çdo i dyti qytetar/e nuk e di se në Mal të Zi ekzistojnë këshilla kombëtare të komuniteteve pakicë;

- Çdo i treti i anketuar konsideron se në tekstet shkollore në Mal të Zi janë të pamjaftueshme temat që trajtojnë kulturën e popujve pakicë;

- Më shumë se dy të tretat e të anketuarve s'e dinë se cilët mekanizma mbrojtës kundër diskriminimit kanë pakicat në Mal të Zi;

- Shumica e të anketuarve që janë të njohur me mekanizmat ligjorë për mbrojtjen e të drejtave të pakicave, konsiderojnë se zbatimi i tyre nuk është i kënaqshëm;

- 46.7% e të anketuarve konsiderojnë se nuk respektohet mjaftueshëm e drejta e pakicave për përfaqësim proporcional në sektorin publik dhe në qeverisje;

- Çdo i dyti i anketuar beson se partitë politike në programet e tyre s'merren mjaftueshëm me të drejtat e pakicave, kurse 51.8% e qytetarëve dhe qytetareve konsiderojnë se përfaqësuesit e komunitetit të tyre kombëtar s'janë të përfaqësuar mjaftueshëm në pozicionet vendimmarrëse në nivel shtetëror;

- Më shumë se gjysma e të anketuarve nuk janë të njohur me punën e Ministrisë së të Drejtave të Njeriut dhe të Pakicave, por pothuajse dy të tretat e qytetarëve dhe qytetareve vlerësojnë pozitivisht punën e saj në fushën e realizimit të të drejtave të pakicave;

- 46.3% e të anketuarve konsiderojnë se diskriminimi nuk ekziston në masë të konsiderueshme dhe se nuk përbën problem që pushteti ekzekutiv duhet ta zgjidhë në afat të shkurtër;

- Të anketuarit konsiderojnë se Shërbimi Publik Radio dhe Televizioni i Malit të Zi dhe mediat private kryesisht raportojnë pozitivisht për komunitetet e tyre kombëtare;

- Qytetarët dhe qytetaret do t'i drejtoheshin fillimisht policisë dhe organeve inspektuese nëse do të ishin viktima të diskriminimit mbi bazë kombëtare;

- 38.8% e të anketuarve konsiderojnë se ndërmjet pjesëtarëve të grupeve të ndryshme kombëtare mund të arrihet bashkëpunim, por jo edhe besim i plotë;

- Të anketuarit janë kryesisht të polarizuar kur bëhet fjalë për lidhjen e martesës me pjesëtarë të kombësive të tjera;

- 54% e të anketuarve s'do të ishin në martesë me një partner ose partnere që i përket komunitetit rom;

- Çdo i treti i anketuar konsideron se shumica e incidenteve që dëshmojmë në shoqëri në dy vitet e fundit janë kryesisht të motivuara nga mosdurimi kombëtar;

- Si arsye shtesë të incidenteve publike në shoqërinë malazeze, shumica e të anketuarve identifikojnë interesat politike dhe manipulimin, pakënaqësinë me situatën ekonomike, edukimin e pamjaftueshëm si dhe korrupsionin.

I Perceptimet për praninë e diskriminimit

Shoqëritë në të cilat qytetarët kanë bindje të forta se diskriminimi ekziston, cilësohen nga një nivel i lartë mosbesimi, paqëndrueshmërie dhe nga mungesa e kohezionit shoqëror. Rezultatet e këtij hulumtimi tregojnë se çdo i dyti i anketuar konsideron se diskriminimi është kryesisht i pranishëm në Mal të Zi:

Grafiku 1. Duke folur përgjithësisht, në çfarë mase është i pranishëm diskriminimi në Mal të Zi?



Perceptimet e theksuara për diskriminimin janë një nga treguesit që sugjerojnë se qytetarët dhe qytetaret s'e përjetojnë shoqërinë malazeze si gjithëpërfshirëse. Është veçanërisht e rëndësishme të theksohet rritja e perceptimeve për diskriminimin, duke qenë se në vitin 2010, 45.9% e qytetarëve dhe qytetareve të Malit të Zi besonin se diskriminimi ishte shumë i pranishëm, kurse në vitin 2020 kjo përqindje ishte 38.5% (Bešić 2020, 17).

Një interpretim i plotë i qëndrimeve mbi praninë e diskriminimit nuk është i mundur pa një kontekst shtesë. Konkretisht, të anketuarit besojnë se diskriminimi në Mal të Zi është më i pranishëm për shkak të bindjeve politike:

Tabela 1. Në çfarë mase është i pranishëm diskriminimi bazuar në kriteret e mëposhtme:

	Shumë i pranishëm	Kryesisht i pranishëm	Kryesisht i papranishëm	Aspak i pranishëm	Nuk di/ Nuk dua të përgjigjem
1. Gjinia/Seksi	19,4%	30,7%	26,5%	20,9%	2,4%
2. Kombësia	24,1%	40,2%	20,6%	12%	3%
3. Përkatësia fetare	22,6%	36,7%	23%	14,7%	2,9%
4. Bindja politike	25,8%	43%	18,2%	10,5%	2,4%
5. Mosha	14,2%	26,8%	30,1%	25,4%	3,4%
6. Invaliditeti	18,4%	34,6%	26,6%	16,7%	3,6%
7. Orientimi seksual	29,8%	38,3%	18,1%	9,5%	4,2%

Në vendin e dytë për nga prania është kriteri i orientimit seksual, duke qenë se 68.1% e të anketuarve besojnë se ky faktor zakonisht shkakton diskriminim, kurse përkatësia kombëtare është gjithashtu e theksuar si shkak i diskriminimit për 64.3% të të anketuarve. Të dhënat mbi bazat më të pranishme të diskriminimit pasqyrojnë kontekstin e përgjithshëm politik dhe shoqëror në Mal të Zi. Mali i Zi ishte shteti i vetëm i bllokut postkomunist në Evropë që për tri dekada rresht nuk kishte ndërruar pushtetin. Mali i Zi është në një periudhë të zgjatur të paqëndrueshmërisë politike, pasi janë formuar tri qeveri pas rrëzimit të Partisë Demokratike të Socialistëve (DPS). Mungesa e marrëveshjeve politike konstruktive, mungesa e reformave kyçe në gjyqësor, hakmarrja politike, polarizimi dhe politizimi shtesë i administratës shtetërore ndikojnë në perceptimet e publikut dhe komplikojnë procesin e integrimit evropian. Në Raportin e fundit të Komisionit Evropian është konstatuar se paqëndrueshmëria politike dhe polarizimi i thellë janë faktorët kryesorë që kanë ngadalësuar reformat evropiane (Raporti i KE-së, 2023, 2). Sondazhet e opinionit publik tregojnë se 20% e qytetarëve besojnë se hakmarrja politike ushtrohet ndaj kundërshtarëve politikë (CEDEM 2024, 21), kurse çdo i dyti beson se partitë politike janë përgjegjëse për ndarjet në shoqërinë malazeze (Qendra për Arsimim Qytetar 2023).

Perceptimet e theksuara për diskriminimin mbi bazën e orientimit seksual mund të interpretohen në dy mënyra. Në vitin 2020, Mali i Zi miratoi Ligjin për partneritetin jetësorë midis personave të të njëjtit seks ("Fletorja Zyrtare e Malit të Zi", nr. 067/20 më datë 07.07.2020), i cili është një hap të rëndësishëm për përmirësimin e të drejtave dhe lirive të njeriut. Aktualisht është duke u diskutuar Ligji për njohjen ligjore të identitetit gjinor në bazë të vetëpërcaktimit, i cili do t'u mundësojë të gjithë individëve zhvillimin e lirë dhe autentik të personalitetit dhe identitetit të tyre, që mund të jetë i ndryshëm nga karakteristikat biologjike gjinore të lindjes. Pavarësisht nga përparimet ligjore, diskriminimi ndaj komunitetit LGBTQI vazhdon. Në raportet[1] ndërkombëtare përkatëse është vënë në dukje se diskriminimi mbi bazën e identitetit gjinor dhe orientimit seksual është i theksuar në Mal të Zi, dhe se personat LGBTQI shpesh janë subjekt i gjuhës së urrejtjes. Nga ky aspekt, perceptimet për diskriminimin mbi bazën e orientimit seksual të vërejtura në këtë studim reflektojnë gjendjen e vërtetë të të drejtave të njeriut në Mal të Zi. Njëkohësisht, fakti që më shumë se dy të tretat e të anketuarve e njohin këtë kriter si shkak për diskriminim tregon për rritjen e vetëdijes së qytetarëve për pozitën e pabarabartë, trajtimin e pabarabartë dhe trajtimin e padrejtë të personave që dalin jashtë normave heteroseksuale dhe patriarkale.

Më tej, kriteri i kombësisë në Mal të Zi nuk është vetëm një çështje e konflikteve politike, por edhe një faktor që ndikon ndjeshëm në kohezionin shoqëror, realizimin e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe nivelin e përgjithshëm të besimit shoqëror. Në fakt, çdo i dhjeti i anketuar është ndjerë ndonjëherë i kërcënuar për shkak të përkatësisë së tij kombëtare:

Grafiku 2. A jeni ndjerë ndonjëherë i kërcënuar për shkak të përkatësisë suaj kombëtare?



1 Shih: Raporti mbi të drejtat e njeriut për Malit të Zi për vitin 2023, Ambasada e SHBA-së, Raporti i Komisionit Evropian për progresin e Malit të Zi për vitin 2023.

Fakti që më shumë se 70% e të anketuarve kanë dhënë një përgjigje negative në këtë pyetje është inkurajues, por interpretimi i përgjigjeve të qytetarëve që kanë përjetuar ndjenjën e kërcënimit për shkak të përkatësisë kombëtare shkallëzon më tej nivelet dhe llojet e diskriminimit në Mal të Zi. Para së gjithash, midis të anketuarve që ndonjëherë janë ndjerë të kërcënuar për shkak të identitetit të tyre kombëtar, dominojnë anëtarët e komunitetit boshnjak – një e katërta e të anketuarve që kanë dhënë përgjigje pozitive për këtë pyetje i përkasin kombësisë boshnjake.

Shumica e të anketuarve që kanë përjetuar ndjenjën e kërcënimit për shkak të identitetit të tyre kombëtar, theksojnë vështirësitë në gjetjen e një pune, veçanërisht në sektorin publik. Disa të anketuar përmendin trajtime mjekësore të vonuara ose trajtim të pabarabartë në shëndetësi për shkak të përkatësisë politike ose kombëtare. Përgjigjet përfshijnë gjithashtu incidente të ndjenjës së presionit për të votuar për parti të caktuara, si dhe një ndjenjë të përgjithshme kërcënimi ose diskriminimi në aspekte të ndryshme të jetës, përfshirë përdorimin e emrave përçmues, sulme verbale dhe fizike.

Disa të anketuar tregojnë për burokraci të qëllimshme që e lidhin me përkatësinë e tyre kombëtare, duke ndikuar në aftësinë e tyre për të pasur qasje në shërbime ose të drejta. Ka disa përgjigje për ndjenjë të pasigurisë ose diskriminimit gjatë ngjarjeve fetare dhe në ndërveprime shoqërore, mbi bazën e përkatësinë kombëtare.

Rastet e përmendura përfaqësojnë shembuj të diskriminit organizativ ose strukturor, ku një organizatë ose strukturë shoqërore favorizon anëtarët e grupeve të caktuara kombëtare mbi të tjerët (Bešić 2020, 8). Pasojat afatgjata të këtyre praktikave janë armiqësia, ndarja dhe konflikti midis anëtarëve të grupeve shumicë dhe pjesës tjetër të komunitetit shoqëror, për të cilat pjesërisht tregon edhe ky hulumtim, duke qenë se 37% e të anketuarve besojnë se anëtarët e disa grupeve kombëtare janë të privilegjuar në krahasim me të tjerët. Kur u pyetën se cilat grupe kombëtare janë të privilegjuara, shumica e qytetarëve përgjigjen se fjala është për komunitetin malazez dhe serb:

Tabela 2. Përfaqësuesit e cilave grupe kombëtare, sipas mendimit tuaj, janë të privilegjuar në krahasim me të tjerët?

	Tërësisht të privilegjuar	Pjesërisht të privilegjuar	Kryesisht të paprivilegjuar	Aspak të privilegjuar	Nuk di/ Nuk dua të përgjigjem
Malazezët	31,5%	22,5%	13,2%	18,4%	14,4%
Serbët	32,2%	26,2%	15,5%	11,7%	14,4%
Shqiptarët	4,5%	17,5%	32,8%	28,2%	17,1%
Muslimanët	6,0%	23,5%	28,0%	27,6%	15%
Boshnjakët	6,2%	21,9%	27,8%	28,9%	15,1%
Kroatët	3,9%	15,3%	33,4%	30,5%	16,9%
Romët	6,0%	9,5%	19,6%	53,4%	11,5%

Përveç se të dhënat tregojnë për nivelin e privilegjimit, është po aq e rëndësishme të interpretohet pozicioni i atyre që konsiderohen më pak të favorizuar në raport me të tjerët. Tabela 2 tregon se vetëm 15.5% e të anketuarve besojnë se Romët janë në një pozicion të privilegjuar krahasuar me komunitetet e tjera kombëtare. Kjo është në përputhje me perceptimet e përgjithshme të diskriminimit, pasi hulumtimi ka treguar se komuniteti rom është thellësisht më i diskriminuari në Mal të Zi:

Tabela 3. Pjesëtarët e cilave grupe kombëtare, sipas mendimit tuaj, janë më të diskriminuar në Mal të Zi?

	Tërësisht të diskriminuar	Pjesërisht të diskriminuar	Kryesisht të padiskriminuar	Aspak të diskriminuar	Nuk di/ Nuk dua të përgjigjem
Malazezët	8,9%	14,5%	36,7%	35,7%	4,1%
Serbët	6,2%	18%	36,6%	35,5%	3,6%
Shqiptarët	11,2%	28%	31,6%	24,8%	4,3%
Muslimanët	11,8%	26,4%	34,4%	23,9%	3,4%
Boshnjakët	11,2%	25,4%	37,2%	22,4%	3,7%
Kroatët	8,9%	26,7%	36,2%	23%	5,1%
Romët	36,3%	39,7%	12,3%	8,6%	3%

Në fakt, mbi 75% e të anketuarve besojnë se Romët janë plotësisht ose kryesisht të diskriminuar. Në analizën e Avokatit të Popullit të Malit të Zi theksohet se pozicioni “Romëve dhe Egjiptianëve është ende i pafavorshëm në të gjitha aspektet kryesore të jetës” (Raporti i Avokatit të Popullit 2023, 63), dhe se komuniteti rom dhe egjiptian është katër deri në pesë herë më në rrezik të varfërisë në krahasim me pjesën tjetër të popullsisë (Raporti i Avokatit të Popullit 2020, 63).

Të anketuarit besojnë se përfaqësuesit e komuniteteve të pakicave janë më të diskriminuar në sektorin privat të punësimit:

Tabela 4. Në cilat nga fushat e listuara mendoni se përfaqësuesit e komuniteteve të pakicave janë më të diskriminuar?

	Plotësisht të diskriminuar	Kryesisht të diskriminuar	Kryesisht të padiskriminuar	Aspak të diskriminuar	Nuk di / nuk dua të përgjigjem
Në fushën e punësimit në sektorin publik	7,9%	27,9%	35,9%	24,8%	3,4%
Në fushën e punësimit në sektorin privat	14,1%	33,7%	30,5%	17,3%	4,3%
Në ushtrimin e të drejtave para gjykatave	11,7%	25,8%	36,5%	18%	7,9%
Në fushën e arsimit	10,2%	27,2%	35,9%	22,8%	3,8%
Në fushën e mbrojtjes shëndetësore	8%	26,4%	37,5%	24,3%	3,7%

Megjithatë, kur i shtojmë kësaj edhe kriterin e përkatësisë etnike, perceptimet e diskriminimit të komunitetit rom në fushat e punësimit dhe të mbrojtjes shëndetësore janë më të theksuara:

Tabela 5. Në çfarë mase janë përfaqësuesit e këtyre pakicave të diskriminuar në fushën e punësimit?

	Tërësisht të diskriminuar	Pjesërisht të diskriminuar	Kryesisht të padiskriminuar	Aspak të diskriminuar	Nuk di/ Nuk dua të përgjigjem
Serbët	6,2%	15,5%	37,1%	35,9%	5,2%
Shqiptarët	7,1%	24,9%	34,1%	27,1%	6,7%
Muslimanët	9,4%	23,4%	37,3%	24,6%	5,2%
Boshnjakët	9,2%	23,2%	36%	25,8%	5,7%
Kroatët	5,9%	22,1%	39,6%	24,7%	7,6%
Romët	28,4%	41%	14,3%	10,1%	6,1%

Tabela 6. Në çfarë mase janë pjesëtarët e këtyre pakicave të diskriminuar në fushën e mbrojtjes shëndetësore?

	Tërësisht të diskriminuar	Pjesërisht të diskriminuar	Kryesisht të padiskriminuar	Aspak të diskriminuar	Nuk di/ Nuk dua të përgjigjem
Serbët	4,7%	11,3%	36,1%	43,8%	4%
Shqiptarët	7%	19,3%	32,3%	37,1%	4,2%
Muslimanët	7,4%	19,1%	33,1%	36,3%	4%
Boshnjakët	7%	17,7%	35,8%	35,1%	4,3%
Kroatët	6,3%	18,8%	35,8%	34,3%	4,7%
Romët	18%	29%	24,2%	22%	6,7%

Siç tregojnë Tabelat 4 dhe 5, pothuajse 70% e të anketuarve besojnë se Romët dhe Romet janë komuniteti më i diskriminuar në fushën e punësimit, kurse 47% e të anketuarve mendojnë se ka një nivel të lartë diskriminimi edhe në fushën e mbrojtjes shëndetësore. Qeveria e Malit të Zi ka miratuar Strategjinë për përfshirjen sociale të Romëve dhe Egjiptianëve për periudhën 2021–2025. Në raportin e tij të vitit 2017, Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës i ka rekomanduar Malit të Zi një sërë masash konkrete, ndër të cilat është rritja e pranisë së ndërmjetësve (mediatorëve) dhe asistentëve romë në arsimin parashkollor dhe fillor, për të parandaluar pjesëmarrjen e ulët të komunitetit rom në edukim, gjë që më pas ndikon në mundësinë e punësimit. Numri i përgjithshëm i bashkëpunëtorëve në fushën e arsimit, punësimit, kujdesit shëndetësor dhe mbrojtjes sociale arrin në 47, dhe gjithashtu ka filluar hartimi i Programit Kombëtar për transformimin e punësimit informal të Romëve dhe Egjiptianëve në Mal të Zi. Gjatë vitit 2023 u krijua një Trup Koordinues për ndjekjen e zbatimit të Deklaratës së Partnerëve të Ballkanit Perëndimor për integrimin e Romëve/eve në kuadër të procesit të zgjerimit të Bashkimit Evropian.

Pavarësisht nga disa përparimet në aspektin sasior, popullsia rome është ende e integruar në mënyrë të pamjaftueshme, nuk ka mundësi të barabarta në arsim, punësim, kujdes shëndetësor, të ardhura dhe pjesëmarrje politike (Raporti i Avokatit të Popullit 2023, 63). Në analizën e Ambasadës së SHBA-së mbi gjendjen e të drejtave të njeriut në Mal të Zi për vitin 2023, thuhet se "autoritetet nuk i kanë zbatuar në mënyrë efektive rregulloret që mbrojnë përfaqësuesit e grupeve racore ose etnike nga dhuna" (Ambasada e SHBA-së 2023, 23), dhe se Romët, Egjiptianët dhe Ashkalinjtë mbeten viktimat më të cenueshme të diskriminimit (Ambasada e SHBA-së 2023, 24).

Përveç monitorimit të rregullt të niveleve, llojeve dhe pranisë së diskriminimit, për një shoqëri ku pakicat do të ndihen të integruar dhe të mbrojtur, janë të nevojshëm disa mekanizma, si masat afirmative që duhet të përfshijnë masa për eliminimin e diskriminimit struktural. Në shoqëritë ku mbrojtja e të drejtave të pakicave vlerësohet shumë, informimi mbi masat afirmative është më i lartë edhe në popullatën shumicë (Fruhstorfer dhe Hudson 2022). Në

këtë kontekst, është tregues fakti që madje 74% e të anketuarve nuk janë të informuar për masat afirmative gjatë punësimit të pjesëtarëve të pakicave kombëtare:

Grafiku 3. A jeni të informuar për masat afirmative gjatë punësimit të pjesëtarëve të pakicave kombëtare?



Ndër ata që janë përgjigjur pozitivisht, shumë prej tyre përmendin përfaqësimin proporcional të pakicave në qeveri dhe në institucionet shtetërore. Disa të anketuar përsëri theksojnë rëndësinë e përkatësisë politike gjatë punësimit, ku anëtarësimi në disa parti shpesh tejkalon përkatësinë etnike ose kombëtare. Anëtarësimi në parti shpesh përmendet si faktor kyç për punësim, ndërsa disa të anketuar shprehin skepticizëm ose zhgënjim në efektivitetin dhe zbatimin e saktë të masave afirmative, duke theksuar se rregulloret zbatohen dobët ose janë vetëm nominale, pa ndonjë efekt të vërtetë.

Kushtetuta e Malit të Zi, në nenin 79, garanton përfaqësim autentik për përfaqësuesit e pakicave kombëtare dhe komuniteteve kombëtare të pakicave, në përputhje me parimet e masave afirmative, në Kuvendin e Malit të Zi, kuvendet e njësive të vetëqeverisjes lokale, përfaqësim proporcional në shërbimet publike, organet e qeverisjes shtetërore dhe të vetëqeverisjes lokale. Po i njëjti nen garanton të drejtën për formimin e këshillave për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të veçanta të pakicave. Sipas këtij hulumtimi, çdo qytetar i dytë në Mal të Zi s'e di që ekzistojnë këshilla kombëtare të komuniteteve të pakicave:

Grafiku 4. A e dini që në Mal të Zi ekzistojnë këshilla kombëtare të komuniteteve të pakicave?



Në Mal të Zi, pakicat përmes këshillave të tyre kombëtare punojnë për përmirësimin e pozicionit të tyre shoqëror, ekonomik, social dhe politik si dhe për ruajtjen dhe zhvillimin e kulturës së tyre. Megjithatë, pavarësisht nga garancitë kushtetuese dhe ligjore, popullsia rome, egjiptiane dhe muslimane ende nuk ka përfaqësuesit e saj në Kuvendin e Malit të Zi. Veçanërisht shqetësuese është fakti që sektori joqeveritar dhe vëzhguesit që merren me çështje ligjore vazhdojnë të akuzojnë autoritetet për përvetësim të paligjshëm të fondeve nga Fondi për Financimin e Këshillave Kombëtare (Ambasada e SHBA-ve 2023, 24).

Përveç mekanizmave të përmendur, një instrument shumë i rëndësishëm i kohezionit shoqëror dhe i multikulturalizmit është arsimi. Çdo i treti i anketuar konsideron se në tekstet shkollore në Mal të Zi janë të pamjaftueshme temat që trajtojnë kulturën e popujve pakicë:

Grafiku 5. Në çfarë mase janë të përfshira në tekstet shkollore në Mal të Zi temat që lidhën me kulturën e popujve pakicë?



Njëkohësisht, mbi 40% e të anketuarve janë kryesisht të njoftuar me kulturën dhe zakonet e popujve pakicë në Mal të Zi:

Grafiku 6. Në çfarë mase jeni të njoftuar me kulturën dhe zakonet e popujve pakicë në Mal të Zi?



Duke marrë parasysh që shumica e të anketuarve nuk ishin të njoftuar me masat e veprimit afirmativ, e gjithashtu mendojnë se, aktualisht, me arsim nuk arrihet mjaftueshëm, njohuria për kulturën dhe zakonet mund të interpretohet kryesisht përmes kontaktit personal dhe bashkëjetesës me komunitete të ndryshme kombëtare.

Rezultatet e paraqitura në këtë kapitull treguan se qytetarët dhe qytetaret janë të bindur se përkatësia politike dhe kombëtare kushtëzon pozicionin shoqëror dhe cilësinë e jetës, ndërsa disa grupe pakicë, si Romët dhe Romet, vazhdimisht perceptohen si më të diskriminuarat. Qëndrimet e qytetarëve dhe qytetareve përbëjnë hyrjen në rëndësinë e mbrojtjes institucionale që shteti i Malit të Zi duhet t'u ofrojë qytetarëve të tij në realizimin e të drejtave dhe lirive të tyre, duke provuar kështu se, pavarësisht harmonizimit të kuadrit ligjor me instrumentet ndërkombëtare, nuk mungon zbatimi efektiv i ligjeve që kanë të bëjnë me ndalimin e diskriminimit dhe mbrojtjen e pakicave.

II Perceptimet për mbrojtjen institucionale

Përveç Kushtetutës, si akti më i lartë juridik, të drejtat e popujve pakicë në Malin e Zi, si dhe të përfaqësuesve të komuniteteve kombëtare pakicë, rregullohen kryesisht nga Ligji për të Drejtat dhe Liritë e Pakicave ("Fletorja Zyrtare e Malit të Zi", nr. 002/11 më datë 12.01.2011, 008/11 më datë 04.02.2011, 031/17 më datë 12.05.2017), dhe në mënyrë indirekte rregullohen nga Ligji për Ndalimin e Diskriminimit ("Fletorja Zyrtare e Malit të Zi", nr. 46/2010, 40/2011 - ligj tjetër, 18/2014 dhe 42/2017).

Në pushtetin ekzekutiv, për zbatimin e të drejtave të pakicave është përgjegjëse Ministria për të Drejtat e Njeriut dhe të Pakicave. Përveç Ministrisë, mbrojtjen ligjore e ofron edhe Avokati i Popullit (Mbrojtësi i të Drejtave dhe i Lirive të Njeriut, ndërsa Fondi për Mbrojtjen dhe Realizimin e të Drejtave të Pakicave dhe Qendra për Ruajtjen dhe Zhvillimin e Kulturës së Pakicave janë themeluar me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për të Drejtat dhe Liritë e Pakicave. Një mekanizëm i rëndësishëm institucional mbrojtës është edhe Komisioni për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut, si një organ punues i Kuvendit të Malit të Zi, që shqyrton propozimet ligjore dhe çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat dhe liritë e njeriut, me fokus të veçantë te të drejtat e pakicave.

Kuadri strategjik për politikat e pakicave në Mal të Zi u formua në vitin 2008, me miratimin e dokumentit të parë strategjik (Ministria për të Drejtat e Njeriut dhe të Pakicave, 2019). Strategjia e re e Politikave për Pakicat (2024-2028) do të miratohet në tremujorin e dytë të këtij viti dhe do të përfshijë pesë fusha: arsimin, kulturën, informimin, punësimin dhe pjesëmarrjen politike (Qeveria e Malit të Zi).

Komisioni Evropian ka miratuar strategjinë për një "Perspektivë të Besueshme për Zgjerimin dhe Bashkëpunimin e Zgjeruar të BE-së me Ballkanin Perëndimor" (Komisioni Evropian, 2018), ku një nga fushat kryesore është forcimi i qeverisjes së mirë, sundimi i ligjit dhe mekanizmat institucionalë, me një fokus të veçantë në ndalimin e diskriminimit dhe forcimin e të drejtave të pakicave (Komisioni Evropian, 2018).

Një nga treguesit e efektivitetit institucional është perceptimi i qytetarëve për nivelin e mbrojtjes institucionale. Para së gjithash, më shumë se dy të tretat e të anketuarve nuk janë të njoftuar me mekanizmat mbrojtës kundër diskriminimit për pakicat në Mal të Zi:

Grafiku 7. A e dini se në ç'mënyrë mbrohen pakicat në Mal të Zi nga diskriminimi?



Të anketuarit që u përgjigjën pozitivisht në pyetje, kryesisht përmendin kuadrin ligjor që lidhet me mbrojtjen e të drejtave të pakicave. Një koment i zakonshëm është se ligjet ekzistojnë, por zbatimi i tyre nuk është i kënaqshëm, ndërkohë që vihet re një nivel i caktuar ndërgjegjësimi për mangësitë në sistemin e mbrojtjes së të drejtave të pakicave, pasi individët shprehin shqetësim se diskriminimi është ende i pranishëm pavarësisht nga mbrojtjet formale ligjore.

Kur bëhet fjalë për vlerësimin nëse shteti po bën përpjekje të mjaftueshme për të luftuar diskriminimin e pakicave, shumica e të anketuarve besojnë se janë të nevojshme përpjekje shtesë:

Grafiku 8. A po bënë shteti i Malit të Zi mjaftueshëm në luftën kundër diskriminimit të pakicave?



Në lidhje të ngushtë me këtë çështje është edhe perceptimi i qytetarëve për nivelin e mbrojtjes ligjore, pasi qëndrimet rreth efektivitetit të kuadrit ligjor janë kryesisht të polarizuara:

Grafiku 9. A mbron Kushtetuta dhe ligjet e Malit të Zi mjaftueshëm të drejtat e popujve pakicë?



Duke marrë parasysh që shumica e të anketuarve, siç e ka treguar edhe ky hulumtim, nuk janë të njohur me mekanizmat e mbrojtjes nga diskriminimi dhe me realizimin e përgjithshëm të të drejtave të popujve pakicë, qëndrimet për jo efektivitetin e kuadrit ligjor kryesisht mund të interpretohen përmes perceptimeve mbi zbatimin e tij. Këshilli i Evropës, në bashkëpunim me Qeverinë e Malit të Zi, ka theksuar nevojën për të përmirësuar efektivitetin e institucioneve që janë përgjegjëse për mbrojtjen e të drejtave të pakicave dhe grupeve vulnerabël. Rekomandimet kryesisht lidhen me përmirësimin e kuadrit ligjor dhe institucional për mbrojtje efektive nga diskriminimi, si dhe me koordinimin më të mirë ndërmjet të gjitha institucioneve (Këshilli i Evropës 2024).

Supozimi për një mospërputhje midis kuadrit formalo-ligjor dhe zbatimit të tij është verifikuar përmes analizës së përgjigjeve të të anketuarve lidhur me respektimin e të drejtave të popujve pakicë në Malin e Zi, sipas nenit 79 të Kushtetutës:

Tabela 7. Në çfarë mase mendoni se respektohen të drejtat e përmendura të popujve pakicë në Malin e Zi?

	Respektohet në masë të madhe	Respektohet pjesërisht	Pjesërisht nuk respektohet	Aspak nuk respektohet	Nuk di / Nuk dua të përgjigjem
E drejta e shprehjes, ruajtjes, zhvillimit dhe manifestimit publik të veçorive kombëtare, etnike, kulturore dhe fetare	22,1%	32,5%	26,7%	14,6%	4%
E drejta për të zgjedhur, përdorur dhe shfaqur publikisht simbolet kombëtare dhe për të festuar festat kombëtare	20%	43,5%	20,5%	12,3%	3,6%
E drejta për arsimim në përputhje me specifikat e çdo pakice	20,3%	33,4%	27,9%	14,1%	4,2%
E drejta për përfaqësim proporcional në shërbimet publike, organet e pushtetit shtetëror dhe të vetëqeverisjes lokale	12,6%	35,1%	28,2%	18,7%	5,3%
E drejta për informim në gjuhën e tyre	16,7%	34,3%	26,4%	16%	6,5%

Përqindja më e madhe (46.7%) e të anketuarve mendon se të drejtat e pakicave për përfaqësim proporcional në sektorin publik dhe në qeveri nuk respektohen pjesërisht ose aspak. Ky rezultat përputhet me perceptimet për diskriminimin mbi bazën e përkatësisë kombëtare dhe orientimit politik, të cilat janë theksuar në pjesën e parë të raportit. Për më tepër, çdo i dyti i anketuar beson se partitë politike në programet e tyre nuk merren sa duhet me të drejtat e pakicave, ndërsa 51.8% e qytetarëve mendojnë se përfaqësuesit e komunitetit të tyre kombëtar janë të papërfaqësuar në pozicionet vendimmarrëse në nivelin shtetëror:

Grafiku 10. A mendoni se çështja e realizimit të të drejtave të popujve pakicë është e përfaqësuar mjaftueshme në programet e partive politike?



Grafiku 11. A mendoni se përfaqësuesit e komunitetit tuaj kombëtar janë të përfaqësuar mjaftueshëm në pozitat vendimmarrëse në nivel shtetëror?



Në të njëjtën kohë, të anketuarit besojnë se të drejtat që lidhen me arsimimin sipas specifikave të çdo pakice nuk respektohen sa duhet, gjë që është në përputhje me qëndrimet e përgjithshme të konfirmuara në këtë studim, ku në materialet arsimore zyrtare nuk i kushtohet mjaftueshëm vëmendje kulturave të popujve pakicë në Mal të Zi.

Një tregues i rëndësishëm i mbrojtjes institucionale janë edhe perceptimet për punën e Ministrisë së të Drejtave të Njeriut dhe të Pakicave. Në këtë studim kemi marrë të dhëna të kundërta. Më shumë se gjysma e të anketuarve nuk janë të njoftuar me punën e Ministrisë në pjesën e realizimit të të drejtave të pakicave, por gati dy të tretat e qytetarëve e vlerësojnë pozitivisht punën e saj:

Grafiku 12. A jeni të njoftuar me punën e Ministrisë së të Drejtave të Njeriut dhe të Pakicave në realizimin e të drejtave të pakicave në Mal të Zi?



Grafiku 13. Si e vlerësoni punën e Ministrisë së të Drejtave të Njeriut dhe të Pakicave në realizimin e të drejtave të pakicave në Mal të Zi?



Ndër të anketuarit që janë të njoftuar me punën e Ministrisë për të Drejtat e Njeriut dhe të Pakicave, dominuan ata të kombësisë boshnjake dhe rome, të cilët janë gjithashtu më të kënaqurit me veprimtarinë e këtij institucioni.

Në çfarë mase qytetarët perceptojnë diskriminimin si një temë të rëndësishme shoqërore, është e dukshme kur kjo fushë vendoset si një nga prioritetet e ekzekutivit. Është inkurajuese që më shumë se 60% e të anketuarve janë të bindur se problemi i diskriminimit duhet të jetë një nga fokuset kryesore të Qeverisë së Malit të Zi:

Tabela 8. Perceptimet për prioritetet e Qeverisë së Malit të Zi në kontekstin e politikës së pakicave

	Plotësisht pajtohem	Kryesisht pajtohem	Kryesisht nuk pajtohem	Aspak nuk pajtohem	Nuk di / Nuk dua të përgjigjem
Problemi i diskriminimit të pakicave duhet të jetë një prioritet i Qeverisë së Malit të Zi sepse shkakton shumë probleme të tjera	21,8%	39,6%	19,2%	13,5%	5,8%
Diskriminimi i pakicave është një problem, por ka probleme më të mëdha që Qeveria e Malit të Zi duhet të zgjidhë sa më shpejt	18,8%	39,6%	21,7%	13,8%	6%
Diskriminimi i pakicave nuk është shumë i përhapur dhe nuk përfaqëson një problem të rëndësishëm që Qeveria duhet ta zgjidhë shpejt	17,4%	28,9%	26,2%	20,9%	6,5%

Mirëpo, siç tregon Tabela 7, madje 46,3% e të anketuarve besojnë se diskriminimi nuk është shumë i përhapur dhe nuk përfaqëson një problem që duhet zgjidhur menjëherë nga ekzekutivi. Mohimi i diskriminimit përfaqëson një tendencë shumë shqetësuese, e cila shpesh bazohet në bindjen se grupet e diskriminuara janë "fajtorë" për pozicionin e tyre ose kërkojnë "më shumë të drejta se sa u takojnë" (Stephens dhe Levine 2011). Përveç qëndrimeve të tilla që përjashtojnë të drejtat dhe liritë e të tjerëve, mohimi i diskriminimit në fakt përfaqëson fillimin e diskriminimit, pasi u mohon personave që janë në një pozicion të nënshtruar në raport me të tjerët mundësinë që gjendja e tyre të bëhet e dukshme dhe të arrijnë ndonjëherë barazi me pjesën tjetër të shoqërisë. Për të rritur ndërgjegjësimin mbi diskriminimin si një

prirje e rëndësishme shoqërore që duhet të bëhet një prioritet politik, është e domosdoshme që të përfshihen edhe mediat si aktorë të rëndësishëm shoqërorë. Në këtë kontekst, të anketuarit në mënyrë të ngjashme njohin punën e mediave publike dhe private në Mal të Zi, duke menduar se të dyja kryesisht raportojnë pozitivisht për komunitetet e tyre kombëtare:

Grafiku 14. Si e vlerësoni informimin dhe raportimin e shërbimit publik RTMZ (RTCG) për komunitetin tuaj kombëtar?



Grafiku 15. Si e vlerësoni informimin dhe raportimin e mediave private për komunitetin tuaj kombëtar?



Në fund, qytetarët dhe qytetaret do t'i drejtoheshin së pari policisë dhe organeve inspektuese nëse do të ishin viktima të diskriminimit mbi bazën kombëtare:

Grafikon 16. Nëse do të ishit viktimë e diskriminimit mbi bazën kombëtare, kujt do t'i drejtoheshit së pari?



Është tregues që Avokati i Popullit dhe gjyqësori nuk perceptohen në masë të madhe si mekanizma mbrojtjeje. Në fakt, neni 21 i Ligjit për ndalimin e diskriminimit ("Fletorja Zyrtare e Malit të Zi", nr. 46/2010, 40/2011 - ligj i ndryshuar, 18/2014 dhe 42/2017) përcakton kompetencat e Avokatit të Popullit, ndër të cilat është edhe trajtimi i ankesave për sjellje diskriminuese, ndërsa në nenin 22 të të njëjtit ligj është e përcaktuar paraqitja e ankesës tek Avokati i Popullit. Një seksion i veçantë i këtij ligji përcakton edhe sistemin e mbrojtjes gjyqësore.

Mosnjohja e Avokatit të Popullit dhe gjyqësorit si organe kompetente në procedurën e konstatimit të diskriminimit është një pasojë logjike e mungesës së përgjithshme të informacionit mbi procedurat e mbrojtjes, siç ka treguar edhe ky hulumtim[2]. Në të njëjtën kohë, është e rëndësishme që këto institucione të forcojnë strategjitë e tyre të komunikimit, në mënyrë që qytetarët të jenë të vetëdijshëm për ndikimin dhe rolin e tyre në luftimin e diskriminimit. Kjo është veçanërisht e rëndësishme sepse Avokati i Popullit perceptohet mirë nga të anketuarit në lidhje me reduktimin e diskriminimit ndaj pakicave, së bashku me sektorin joqeveritar:

Tabela 9. Në çfarë mase institucionet ose organizatat e mëposhtme kontribuojnë në reduktimin e diskriminimit ndaj pakicave?

	Kontribuon në masë të madhe	Kryesisht kontribuon	Kryesisht nuk kontribuon	Aspak nuk kontribuon	Nuk di / Nuk dua të përgjigjem
Kuvendi	7,9%	31,3%	31,6%	19,6%	9,5%
Qeveria	8,4%	37,9%	27,4%	17,1%	9,1%
Gjykatat	8,8%	36,1%	28,2%	17%	9,8%
Organizatat joqeveritare	11%	41,5%	27,9%	10,8%	8,7%
Komunitetet fetare	12,4%	37,5%	25,7%	14,3%	10%
Partitë politike	8,1%	29,4%	34%	20,2%	8,2%
Mediat	8%	38,8%	28,3%	16,3%	8,5%
Këshillat kombëtarë	9,5%	37%	25,4%	14,6%	13,4%
Komuniteti akademik	6,2%	35,9%	28,9%	14,5%	14,4%
Mbrojtësi i të drejtave dhe lirive të njeriut (Avokati i Popullit)	8%	42,2%	22,6%	14,3%	12,8%

2 Shih faqet 22-23

III Distanca etnike

Në shoqëritë me karakter multikulturor, multinacional dhe multireligjioz bashkëjetojnë shumë identitete. Kohezioni shoqëror do të kushtëzohet nga marrëdhëniet mes tyre. Nëse shoqëria ka një orientim qytetar, atëherë veçoritë personale si etniciteti, feja, gjuha, trajtohen si burime të ndryshimeve dhe pluralizmit e jo si baza për diskriminim dhe asimilim.

Shpesh ndodh që etniciteti, feja dhe gjuha të ndërthuren me identitetet politike, gjë që në hapësira me histori të trazuar politike krijon mundësi për konflikte dhe polarizim shoqëror. Një nga efektet anësore të kësaj gjendjeje është distanca e lartë etnike, ose "largësia sociale dhe psikologjike midis përfaqësuesve të grupeve të ndryshme etnike" (Bešić 2023, 11). Shoqëritë që cilësohen nga distanca e theksuar etnike shpesh janë diskriminuese dhe jo përfshirëse. Distanca etnike është një tregues i mirë i dinamikës së përgjithshme etnike, pasi kushtëzon nivelin e besimit shoqëror dhe potencialin e përgjithshëm të shoqërisë për t'u bërë kohezive.

Rezultatet e këtij studimi tregojnë se qytetarët janë kryesisht të pavendosur kur bëhet fjalë për qëndrimet e përgjithshme ndaj përfaqësuesve të grupeve të ndryshme kombëtare:

Tabela 10. Qëndrimet ndaj pjesëtarëve të grupeve të ndryshme kombëtare

	Pajtohem plotësisht	Pjesërisht pajtohem	As pajtohem, as nuk pajtohem	Pjesërisht nuk pajtohem	Aspak nuk pajtohem	Refuzon të përgjigjet	Nuk e di
Mund të ketë bashkëpunim midis përfaqësuesve të grupeve të ndryshme kombëtare, por jo besim të plotë	15,6%	23,2%	21,5%	13%	19,5%	2,3%	4,8%
Njeriu mund të ndihet i sigurt vetëm kur jeton në një mjedis ku shumica e banorëve i përkasin kombit të tij	10,9%	20,1%	30%	12,4%	20,8%	2,3%	3,4%
Martesat kombëtarisht të përziera janë zakonisht më të paqëndrueshme se martesat e tjera	6,9%	15,3%	24,1%	16,6%	28,5%	3,3%	5,2%
Mbijetesa e kombit të vet është detyra kryesore e çdo individi	14,8%	23%	25%	11,6%	17,6%	3,5%	4,4%

Përqindja më e lartë e dakordësisë (38.8%) është për qëndrimin se mund të ketë bashkëpunim midis përfaqësuesve të grupeve të ndryshme kombëtare, por jo besim të plotë. Është tregues që 43.7% e të rinjve të moshës nga 18 deri në 24 vjeç mbështesin këtë bindje. Perceptimi i atyre që nuk i përkasin grupit të vet kombëtar si individë të cilëve nuk mund t'u besohet, është në thelb të distancës sociale. Largimi ndodh si rezultat i pikëpamjeve stereotipe për të tjerët, që në hapësirën e Ballkanit Perëndimor janë shpesh produkt i konflikteve historike dhe politike.

Një nga mënyrat tradicionale të matjes së distancës etnike është shkalla e Bogardus-it, një instrument i standardizuar që përfshin disa tregues të ndërveprimit social midis përfaqësuesve të grupeve të ndryshme, që nga bashkëjetesa në shtet apo lagje, deri te marrëdhëniet e afërta në bashkësi martesore (Mather et al. 2017, 2). Në këtë studim, kemi përdorur disa elementë nga shkalla e Bogardus-it, të cilat kryesisht i përkasin sferës private (martesës, familjes, bashkëjetesës) dhe punësimit. Duke analizuar të dhënat, kemi arritur në përfundimin se të anketuarit janë kryesisht të polarizuar kur bëhet fjalë për martesën me anëtarë të një kombi tjetër:

Grafiku 17. A do të martoheshit me një partner/partnere të kombësisë tjetër?



Nga analiza shtesë kemi arritur në përfundimin se të anketuarit që do të martoheshin me pjesëtarë të një kombi tjetër, do të ishin më pak të prirur ta bënin këtë me Romët dhe Romet. Madje, 54% e të anketuarve nuk do të ishin në martesë me një partner ose partnere nga komuniteti rom:

Tabela 11. A do të martoheshit me përfaqësuesit grupeve të përmendura kombëtare:

	Po	Jo	Nuk di / Nuk dua të përgjigjem
Malazezë	82,4%	7,3%	10,3%
Serbë	65,6%	16%	18,4%
Shqiptarë	37,8%	33,8%	28,4%
Muslimanë	56,1%	20,7%	23,3%
Boshnjakë	53,5%	22,3%	24,2%
Kroatë	46,5%	26%	27,5%
Romë	14,5%	54%	31,5%

Në të njëjtën kohë, analiza e treguesve të tjerë të distancës etnike tregoi se Romët dhe Romet janë grupi, ndaj të cilit ekziston distanca më e madhe, për sa i përket kriterit të punës dhe vendbanimit:

Tabela 12. A do të pranonit një punë ku eprori juaj i përket grupeve të përmendura kombëtare:

	Po	Jo	Nuk di / Nuk dua të përgjigjem
Malazezët	86,4%	6%	7,6%
Serbët	83,3%	8,1%	8,6%
Shqiptarët	72,5%	18,1%	9,4%
Muslimanët	78,1%	12,9%	9%
Boshnjakët	75%	15,8%	9,2%
Kroatët	71,6%	18,4%	10%
Romët	56,3%	29,3%	14,4%

Tabela 13. A do të jetonit në një vend ku fqinjët tuaj i përkasin grupeve të përmendura kombëtare:

	Po	Jo	Nuk di / Nuk dua të përgjigjem
Malazezët	90,3%	4,4%	5,3%
Serbët	88,5%	5,3%	6,2%
Shqiptarët	79,1%	13,4%	7,5%
Muslimanët	84,6%	9,1%	6,3%
Boshnjakët	82%	11,4%	6,6%
Kroatët	78,5%	13,6%	7,9%
Romët	59,5%	28,4%	12,1%

Rezultatet e këtij studimi janë në përputhje me gjetjet e analizave ekzistuese të distancës etnike në Mal të Zi, të cilat tregojnë se përfaqësuesit e të gjitha komuniteteve etnike tregojnë distancimin më të madh ndaj Romëve dhe Romeve (shih: Bešić 2023). Në teoritë bazë të paragjykimeve, të cilat përkufizohen si përgjithësime të pajustifikuara të shoqëruara me qëndrime negative emocionale ndaj të tjerëve (Eagly 2004), përmenden disa parakushte për zvogëlimin e distancës sociale:

1) nëse individët që i përkasin grupeve të ndryshme kanë status të barabartë në disa procese;

2) nëse ndajnë qëllime të përbashkëta;

3) nëse bashkëpunojnë me njëri-tjetrin;

4) nëse kanë mbështetje ligjore, institucionale dhe politike (Allport 1954, sipas: Parrillo dhe Donoghue 2013, 599-600).

Parakushti i fundit është veçanërisht i rëndësishëm sepse strukturat politike kanë qasje të drejtpërdrejtë në një numër të madh instrumentesh për zvogëlimin e distancës sociale dhe, në të njëjtën kohë, janë bartës të një përgjegjësie të madhe. Studimi ka treguar se nuk është përqindje e papërfillshme e atyre që besojnë se shumica e incidenteve që dëshmojmë në shoqëri gjatë dy viteve të fundit janë të motivuara kryesisht nga intoleranca kombëtare. Në fakt, çdo i treti i anketuar është dakord me këtë supozim:

Grafiku 18. A mendoni se shumica e incidenteve që dëshmojmë publikisht në shoqëri gjatë dy viteve të fundit janë kryesisht të motivuara nga intoleranca kombëtare?



Si arsye shtesë për incidentet publike në shoqërinë malazeze, shumica e të anketuarve identifikojnë interesat politike dhe manipulimin. Shumë besojnë se politikanët dhe politikanet përdorin temat kombëtare, etnike dhe sociale për të fituar pikë politike, gjë që kontribuon në krijimin e gjendjes së tensionit dhe shkakton incidente. Për të anketuarit, faktorë të rëndësishëm janë edhe pakënaqësia me situatën ekonomike, pabarazia dhe polarizimi social mes të pasurve dhe të varfërve, pasi besojnë se diferenca gjithnjë në rritje sa i përket qasjes në burime i bën njerëzit të frustruar dhe të ndjeshëm ndaj manipulimeve.

Edukimi i pamjaftueshëm, mosrespektimi i diversitetit dhe intoleranca ndaj pakicave shpesh përmenden si shkaqe të intolerancës dhe të konflikteve. Edukimi dhe mënyra se si individët janë mësuar të sillen ndaj të tjerëve kanë ndikim të madh në kohezionin shoqëror. Faktorë të tjerë janë krimi dhe korrupsioni që krijojnë një atmosferë pasigurie dhe padrejtësie brenda sistemit politik dhe shoqëror.

Analiza e përgjigjeve të të anketuarve çon në përfundimin se në shoqërinë malazeze punohet pamjaftueshëm për përmbushjen e parakushteve për luftimin e paragjykimeve. Kjo lidhet kryesisht me nevojën për forcimin e bashkëpunimit të ndërsjellë, besimit, mbështetjes ligjore, institucionale dhe politike, si dhe për ndërtimin e mundësive të barabarta në arsim, punësim, kujdes shëndetësor, pjesëmarrje politike, dhe barazinë në gëzimin e të drejtave dhe lirive të njeriut.



PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET

Në këtë studim kemi analizuar qëndrimet e qytetarëve dhe qytetareve për përhapjen e diskriminimit në Mal të Zi, llojet dhe përmasat e tija, por edhe për mbrojtjen institucionale, veçanërisht në kontekstin e realizimit të të drejtave të popujve pakicë dhe të përfaqësuesve të komuniteteve kombëtare pakicë. Një segment i veçantë i hulumtimit lidhej me distancën etnike, përkatësisht shkallën e largësisë midis përfaqësuesve të grupeve të ndryshme etnike në Mal të Zi.

Rezultatet e analizës treguan se diskriminimi në Mal të Zi është më i përhapur për shkak të bindjeve politike, orientimit seksual dhe përkatësisë kombëtare. Çdo i dhjeti i anketuar është ndjerë ndonjëherë i rrezikuar për shkak të identitetit të tij kombëtar, dhe shumica e atyre me këtë përvojë kanë theksuar vështirësitë për të gjetur punë, veçanërisht në sektorin publik. Në të njëjtën kohë, shumica e të anketuarve besojnë se komuniteti rom është më i diskriminuari, sidomos në fushën e punësimit dhe kujdesit shëndetësor. Ndaj komunitetit rom ekziston një distancim i madh në sferën private, pasi çdo i dyti qytetar nuk do të lidhte martesë me një anëtar të komunitetit rom.

Të anketuarit zakonisht tregojnë një nivel të ulët njohurish për masat afirmative për përfaqësuesit e popujve pakicë dhe të komuniteteve kombëtare pakicë, dhe njohuritë e tyre për kulturat dhe zakonet janë kryesisht të bazuara në kontaktin personal, pasi, sipas qytetarëve, në sistemin tonë arsimor mësohet shumë pak për këto tema. Përfundimet e përgjithshme të këtij hulumtimi janë se pakicat marrin pjesë në mënyrë të pamjaftueshme në politikë, përmenden në mënyrë margjinale në programet e partive politike dhe përfaqësohen në mënyrë të pamjaftueshme në pozitat vendimmarrëse në nivelin shtetëror.

Është veçanërisht domethënës fakti që pothuajse gjysma e të anketuarve besojnë se diskriminimi nuk përbën një problem të rëndësishëm që pushteti ekzekutiv duhet ta zgjidhë në një kohë të shkurtër, ndërkohë që çdo i treti i anketuar mendon se shumica e incidenteve që dëshmojmë publikisht në shoqëri gjatë dy viteve të fundit janë kryesisht të motivuara nga intoleranca kombëtare.

Duke marrë parasysh gjetjet e këtij studimi, janë formuluar rekomandimet e mëposhtme:

Për institucionet dhe strukturat politike:

- Të vlerësohet efektiviteti i punës së institucioneve në fushën e luftës kundër diskriminimit dhe të rritet transparenca në lidhje me masat e ndërmarra, në mënyrë që publiku i gjerë të informohet me kohë për to;
- Të përmirësohen strategjitë e komunikimit të Ministrisë për të Drejtat e Njeriut dhe të Pakicave dhe Avokatit të Popullit, në mënyrë që qytetarët të jenë më të vetëdijshëm për rëndësinë e këtyre mekanizmave institucionalë për realizimin e të drejtave të popujve pakicë dhe mbrojtjen nga diskriminimi;
- Të rishikohen ligjet në mënyrë që të sigurojnë pjesëmarrje gjithëpërfshirëse të popujve pakicë dhe të komuniteteve kombëtare pakicë që nuk kanë përfaqësues politikë, si pjesëtarët e komuniteteve rome, egjiptiane dhe muslimane;
- Të vlerësohet cilësia e materialeve arsimore në nivelin e arsimit fillor dhe të mesëm nga perspektiva e multikulturalizmit;
- Të trajtohen në mënyrë të qëndrueshme dhe thelbësore përmirësimet e pozitës së pakicave në programet politike;
- Të respektohet e drejta e pakicave për përfaqësim proporcional në sektorin publik dhe në qeveri;
- Në retorikën politike, të inkurajohet respektimi, përfshirja dhe mirëkuptimi ndërmjet etnive.

Për sektorin joqeveritar:

- Të fuqizohen anëtarët e popujve pakicë dhe të komuniteteve kombëtare pakicë në fushën e luftës kundër diskriminimit;
- Përmes edukimit joformal, të punohet për zvogëlimin e stereotipeve për anëtarët e grupeve të ndryshme etnike, veçanërisht për ata që lidhen me komunitetin rom, i cili vazhdimisht tregohet si më i diskriminuari;
- Të ndiqen në mënyrë afatgjatë trendet e diskriminimit, përkatësisht përhapja dhe llojet e saj;
- Të rritet ndërgjegjësimi për rëndësinë e diskriminimit dhe karakterin e tij gjithëpërfshirës;

Për mediat:

- Të kërkojnë përgjegjësinë e institucioneve kompetente për respektimi e të drejtave të popujve pakicë dhe të përfaqësuesve të komuniteteve kombëtare pakicë;
- Të raportojnë për përfaqësuesit/et e grupeve pakicë në role jo-stereotipe;
- Në bashkëpunim me sektorin joqeveritar, të rritet ndërgjegjësimi i publikut të gjerë për diskriminimin.

REFERENCAT

Ambasada SAD-a, (2024). Izvještaj o ljudskim pravima za Crnu Goru za 2023. godinu. https://me.usembassy.gov/wp-content/uploads/sites/250/MONTENEGRO-2023-HUMAN-RIGHTS-REPORT-MNE.pdf, posjećeno: 18. 5. 2024. godine

Bešić, M. (2020). Obrasci i stepen diskriminacije u Crnoj Gori. https://rm.coe.int/hf23-report-patterns-degree-discrimination-cnr/1680a346c7, posjećeno: 18. 5. 2024. godine

Bešić, M. (2023). Etnička distanca u Crnoj Gori. https://www.cedem.me/wp-content/uploads/2024/02/Etnicka-distanca-u-Crnoj-Gori-Decembar-2023.-2.pdf, posjećeno: 19. 5. 2024. godine

CEDEM. (2024). Istraživanja političkog javnog mnjenja. https://www.cedem.me/istrazivanje/objavljeni-rezultati-istrazivanja-politickog-javnog-mnjenja-3/, posjećeno: 18. 5. 2024. godine

Centar za građansko obrazovanje. (2023). Kakva nam država Crna Gora treba?. https://cgo-cce.org/2023/05/24/kakva-nam-drzava-crna-gora-treba/, posjećeno: 19. 5. 2024. godine

Eagly, A. H. (2004). Prejudice: Toward a More Inclusive Understanding.

Evropska komisija. (2018). Vjerodostojna perspektiva proširenja za Zapadni Balkan i pojačano angažovanje EU na Zapadnom Balkanu. https://www.dei.gov.ba/uploads/documents/vjerodostojna-perspektiva-prosirenja-za-2017-godinu_1604654950.pdf, posjećeno: 19. 5. 2024. godine

Evropska komisija. (2023). Izvještaj Evropske komisije o napretku Crne Gore za 2023. godinu. https://www.gov.me/dokumenta/4441000a-7e5c-4b2c-b3f3-661bac4e8736, posjećeno: 18. 5. 2024. godine

Fruhstorfer, A., & Hudson, A. (2022). Majorities for minorities: Participatory constitution making and the protection of minority rights. Political Research Quarterly, 75(1), 103-117.

Izvještaj Ombudsmana. (2023). Izvještaj o zaštiti od diskriminacije sa stanovišta djelovanja institucije Zaštitnika ljudskih prava i sloboda Crne Gore. https://www.ombudsman.co.me/docs/1707806232_polugodisnji%20izvjestaj%202023_29122023.pdf, posjećeno: 18. 5. 2024. godine

Mather, D. M., Jones, S. W., & Moats, S. (2017). Improving upon Bogardus: Creating a more sensitive and dynamic social distance scale. Survey Practice, 10(4).

Ministarstvo za ljudska i manjinska prava. (2019). Strategija manjinske politike 2019-2023. https://wapi.gov.me/download-preview/20beb3bb-2136-457e-be4d-4f8b278e51db?version=1.0, posjećeno: 19. 5. 2024. godine.

Parrillo, V. N., & Donoghue, C. (2013, September). The national social distance study: Ten years later. In Sociological forum (Vol. 28, No. 3, pp. 597-614).

Savjet Evrope. (2024). Jačanje odgovornosti pravosudnog sistema i zaštite prava žrtava u Crnoj Gori. https://www.coe.int/en/web/national-implementation/montenegro-strengthening-accountability-of-the-judicial-system-and-enhancing-protection-of-victims-rights-in-montenegro, posjećeno: 19. 5. 2024. godine

Stephens, N. M., & Levine, C. S. (2011). Opting out or denying discrimination? How the framework of free choice in American society influences perceptions of gender inequality. Psychological science, 22(10), 1231-1236.

Ujedinjene nacije. (2019). Definicija diskriminacije. https://www.un.org/womenwatch/uncoordination/antiharassment.html#:~:text=Discrimination%20is%20any%20unfair%20treatment,social%20origin%20or%20other%20status., posjećeno: 18. 5. 2024. godine

Vlada Crne Gore. (2024). Budva: Održan radni sastanak na temu „Strategija manjinske politike 2024-2028“. https://www.gov.me/clanak/budva-odrzan-okrugli-sto-na-temu-strategija-manjinske-politike-2024-2028, posjećeno: 19. 5. 2024. godine

Burimet juridike

Kushtetuta e Malit të Zi. (“Fletorja Zyrtare e Malit të Zi”, nr. 1/2007 dhe 38/2013 - Amendamentet I-XVI).

Ligji për të drejtat dhe liritë e pakicave (“Fletorja Zyrtare e Republikës së Malit të Zi”, nr. 031/06 më 12.05.2006, 051/06 prej 04.08.2006, 038/07 më 22.06.2007, “Fletorja Zyrtare e Malit të Zi”, nr. 002/11 më 12.01.2011, 008/11 prej 04.02.2011, 031/17 më 12.05.2017).

Ligji për ndalimin e diskriminimit (“Fletorja Zyrtare e Malit të Zi”, nr. 46/2010, 40/2011 - ligj tjetër, 18/2014 dhe 42/2017).

Ligji për partneritetin civil të personave të të njëjtit seks (“Fletorja Zyrtare e Malit të Zi”, nr. 067/20 më 07.07.2020).